

VENDIM
Nr. 50/2020

**PËR KRIJIMIN DHE PËRBËRJEN E KOMISIONIT TË POSAÇËM
PARLAMENTAR PËR SHQYRTIMIN DHE PËRZGJEDHJEN E KANDIDATURAVE
PËR ORGANET DREJTUESE TË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE:
KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE, NËNKOMISIONERIT
SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE, KOMISIONIT RREGULLATOR DHE
KOMISIONIT TË ANKIMIMEVE
DHE SANKSIONEVE**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, nenit 55, të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 17, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, me propozimet e grupeve parlamentare,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Krijimin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Shqyrtimin dhe Përzgjedhjen e Kandidaturave për Organet Drejtuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve: Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisionit Rregullator dhe Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, sipas ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

II. Përbërja e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Shqyrtimin dhe Përzgjedhjen e Kandidaturave është si më poshtë:

a) Nga grupi parlamentar i shumicës parlamentare caktohen:

- | | | |
|--------------------|---------|--|
| 1. Damian Gjikhuri | kryetar | (Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste) |
| 2. Alket Hyseni | anëtar | (Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste) |
| 3. Adnor Shameti | anëtar | (Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste) |

b) Nga grupet parlamentare të pakicës parlamentare caktohen:

- | | | |
|------------------|--------|--|
| 1. Myslim Murri | anëtar | (Grupi Parlamentar Demokrat) |
| 2. Edmond Stojku | anëtar | (Grupi Parlamentar Demokraci dhe Drejtësi) |

III. Procedura e shqyrtimit dhe e përzgjedhjes kryhet sipas dispozitave të Rregullores së Kuvendit për zgjedhjen në organet kushtetuese ose të krijuara me ligj, përveçse kur përcaktohet ndryshe në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

IV. Përzgjedhja e kandidaturave, sipas ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhet në prani të përfaqësuesit të autorizuar, me cilësinë e të dërguarit të posaçëm, të partive parlamentare të dala nga zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2017, që kanë humbur përfaqësimin parlamentar.

V. Komisioni e përfundon veprimtarinë e tij brenda datës 2 tetor 2020. Në rast nevojë, me kërkesë të arsyetuar dhe vendim të Komisionit, Kuvendi vendos zgjatjen e afatit të ushtrimit të veprimtarisë së Komisionit.

VI. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për krijimin e kushteve të punës, si dhe për mbështetjen me burime njerëzore, financiare dhe logjistike të veprimtarisë së këtij Komisioni të Posaçëm.

VII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 17.9.2020.

